



Buletini i Shkencave Gjeologjike

1/2019

Buletin of Geological Sciences

BORDI EDITORIAL

ASS. PROF. DR. VEIP GJONI-KRYEREDAKTOR
PROF. DR. ALAUDIN KODRA-ANËTAR
PROF. DR. IRAKLI PRIFTI-ANËTAR
PROF. DR. VILSON SILO-ANËTAR
ASS. PROF. DR. HASAN KULIQI-ANËTAR
PROF. DR. ALEKS VRANAI-ANËTAR
ASS. PROF. DR. KUJTIM ONUZI-ANËTAR
DR. NDOC VUKZAJ-ANËTAR
ING. SOKOL MARKU-REDAKTOR PËRGJEGJËS

ISSN 0254-5276

Nivele të Beriasian-Valanzhinianit në pjesën e poshtme të platformës karbonatiketë Malit të Shenjtë

[The presence of Beriassian-Valanginian at the basal part of Mali i Shenjte carbonate platform]

Andreea Uta 5 [19]

Modeli tektonik i zonës Jonike në rajonin Gjirokastër-Filat (Greqi) me struktura të mundëshme kërkimi për hidrokarbure

[The tectonic pattern of the Ionian zone in Gjirokastra-Filat region (Greece) and its potential hydrocarbon exploration]

Agim Mësonjësi, Marjeta Bonjako 33 [41]

Antiklinori Kostenjë-Okshtun dhe perspektiva naftëgazmbajtëse e tij

[The Anticline Kostenje-Okshtun and its oil- and gas-bearing perspective]

Fotaq Lula, Piro Dorre, Ervin Lula 49 [59]

Zhvillimi hidrogjeokimik i ujërave nëntokësore të zhavorreve të pellgut Tiranë-Ishëm

[Hydrogeochemical development of Tiranë-Ishëm gravelly basin]

Entela Vako, Arben Pambuku 69 [77]

In memoriam

Në nderim e kujtim të Prof. Dr. Agim Pirdeni

Prof. Dr. Alaudin Kodra, Dr. Ndoc Vukzaj i

Në nderim e kujtim të Prof. Dr. Irakli Premti

Dr. Viktor Doda iii

Në nderim e kujtim të Ing. Ndoc Uci

Dr. Viktor Doda, Ing. Kujtim Gjoka v

NIVELE TË BERIASIAN-VALANZHINIANIT NË PJSËN E POSHTME TË PLATFORMËS KARBONATIKE TË MALIT TË SHENJTË

Andreea Uta*

ABSTRACT

Ky artikull paraqet rezultatet paraprake të studimit biostratigrafik dhe mikrofacial të gëlqerorëve të prerjes së Malit të Shejntit (zona e Mirditës). Foraminiferet bentike dhe "mikroproblematikat" (organizma mikrobiale) janë përbërësit kryesorë të mjediseve riforë dhe platformave karbonatike të Kretakut të Poshtëm. Është provuar gjithashtu se ato janë të një rëndësie të veçantë për zonimin e tyre. Duke qenë një përzierje e elementeve tipike të mjediseve të cekëta (foraminiferet dhe mikroproblematikat) dhe elementëve tipike të mjediseve të thella (calpionelide-ve), microfaciet e përshkruara në këtë studim janë tipike për gëlqerorët allodapikë (turbiditë). E gjithë prerja mund të interpretohet si sedimente të shpatit dhe rrjedhje të shpatit. Në bazë të bashkëshoqërimeve të foraminiferëve, algave dhe të kalpionelidëve, moshë e këtyre depozitimeve është përcaktuar si e Beriasian-Valanzhinianit duke paraqitur të dhëna të rëndësishme për praninë e niveleve të Beriasian-Valanzhinianit në pjesën më të poshtme të platformës karbonatike të Malit të Shenjtë.

Fjalë Kyç: mikrofacies, strukturë mikrobiale, foraminifere, alga gëlqerore, kalpionelide, beriasian - valanzhinian, Mali i Shejntë, Zona Mirdita.

HYRJE

Studimi i gjeologjisë së depozitimeve të moshës Jurasiko-Kretake dhe Kretake, të cilat shtrihen gjerësisht mbi ofiolitet dhe mbulesen e tyre parësore sedimentare, ka rëndësi të madhe për të rindertuar historinë e evolucionit gjeologjik të Zonës Mirdita. Interpretimet gjeologjike regjionale tepër të ndryshme që jepen nga mjaft studime, shtrojnë nevojën e thellimit të studimeve që do të ndihmonin në krijimin e një mundësie sa më të besueshme të evolucionit të kësaj zone.

HISTORIKU I STUDIMEVE GJEOLGJIKE TË MALIT TË SHENJTË

Shumica e studimeve (Peza et al. 1981, 1983, Peza&Marku 2002, Xhomo et al. 2002, 2005), strukturën gjeologjike të depozitimeve karbonatike të Malit të Shenjtit e kanë trajtuar si një pjesë të një platforme të gjerë, me moshë Baremian-Aptian, me shtrirje transgresive mbi depozitimet jurasiko-kretake të flishit Firza

ose mbi ofiolitet dhe mbulesen e tyre sedimentare parësore.

Gawlick et al. (2008) dhe Schlagintweit et al. (2012), moshën më të vjetër të platformës karbonatike të Malit të Shenjtit e pranojnë si të Aptianit dhe gabimisht flihin Firza të Jurasiko- Kretakut, në pjesën veriperendimore dhe perendimore të Malit të Shenjtit, e trajtojnë si të moshës Bathonian-Oksfordiane.

Artikulli që e paraqesim sjell të dhëna të rëndësishme për praninë e niveleve të Beriasian-Valanzhinianit në pjesën më të poshtme të platformës karbonatike të Malit të Shenjtit.

NDËRTIMI GJEOLGJIK I ZONËS

Ofiolitet e zonës Mirdita përfaqësojnë mbetje të litosferës oqeanike Triasike dhe Jurasike, me ruajtjen më të mirë në gjithë brezin Dinarid-Albanid-Helenid të sistemit orogjenik alpin. Mbulesa sedimentare parësore e ofioliteve, gjatë zgjerimit deri

*Instituti i Gjeoshkencave, Energjise, Ujit dhe Mjedisit, Rruga Don Bosko 60. Tirana, Albania
e-mail: andrea.uta@gmail.com

në mbylljen e pellgut oqeanik të Mirditës, përfaqësohet nga silicorë radiolaritike të Jurasikut të mesëm (Marcucci et al., 1994, Prela 1996, 2000) dhe melanzhi “bllloqe në matriks”, “Simoni” i Jurasikut të mesëm-të sipërm: Kallovia-Oksfordian i poshtëm (Xhomo et al. 2002, Kodra & Hoxha 2019). Pas mbylljes së basenit oqeanik të Mirditës, depozitime të Jurasikut të sipërm, Jurasiko-Kretakut dhe Kretakut, mbulojnë ofiolitet dhe mbulesen e tyre sedimentare parësore. Në Shqipëri, dëshmi e depozitimeve të Jurasikut të sipërm është vetëm një shfaqje e kufizuar në rajonin e Kurbneshit, ku brekçie me cop ate Kimerixhianit janë të ridepozituara në fliшин Firza të Tithonianit të sipërm-Beriasianit (Gawlick et al. 2008, Schlagintweit et al. 2012). Depozitime të Jurasikut të Sipërm janë dokumentuar nga Elezaj & Kodra (2008), Kodra et al., (2009), Sukaj (2016) në rajonin Volljak-Guri i Zi, në Kosovë. Formacioni i melanzhit “Simoni” dhe peridotitet e obduktuara mbi të, mbulohen me mospajtim sktrukturor nga brekçie ofiolitike dhe nga silicorët radiolaritike. Copëza të Oksfordian-Kimerixhianit dhe në vijim fliशि “Valljahu” i Kimerixhian- Titonianit. Depozitimet e flishit “Firza” të Titonianit të sipërm-Valanzhinianit përhapen gjerësisht në zonën e Mirditës dhe përfshijnë edhe rajonin e studiuar prej nesh (Fig.1), (Melo et al., 1971, Meco et al 1975, Peza et al., 1983, Gawlick et al., 2008, Uta 2018). Depozitimet e Kretakut përgjithësisht shtrihen transgresivisht mbi formacionet e poshtështruara (Peza et al 1981., Xhomo et al., 2002, 2005).

PRERJA SHENJTI 1 (SHELBUMI)

Prerja e Shentit 1 është kryer në vargmalin e Shenjtit, në veri të majës së Shëlbumit, në buzë të rrugës automobilistike, në afërsi të fshatit Nënshajt. Në dallim me situatat gjeologjike të zakonshme, ku depozitimet kretake shtrihen transgresivisht mbi depozitimet e flishit “Firza” me moshë Titonian i sipërm - Valanzhinian, prerja Shenjt 1 i përket pjesës më të poshtme të prerjes karbonatike të malit të Shenjtë. Përgjatë prerjes, nuk duken shkeputje

tektonike të rëndësishme që të kenë çenuar njëpasnjëshmërinë e shtresave. Prerjen e Shenjtit e kemi ndare në 3 pjesë: të poshtme, të mesme dhe të sipërme, ku janë marrë 120 kampione gjatë viteve 2015-2016, në të cilat kemi përcaktuar mikrofaciet dhe bashkëshoqërimet e tyre mikrofaunistike nëpërmjet përcaktimit të foraminifereve bentosike, algave gëlqerore, organizmave mikrobiale, kalpionelideve dhe kalcisfereve.

Në fillim të prerjes shfaqet një trashësi e kufizuar konglobrekçiesh, me material kryesisht ofiolitik (copa e grimca bazaltesh, gabrosh, mikrogabrosh etj.). Pjesa e mesme e prerjes karakterizohet nga facie relativisht e thellë me gëlqerorë me thjerza e ndërshtrësia silicore, si dhe ndërshtrësia mergelore etj., kuse në pjesën e sipërme të prerjes kemi kalimin normal, gradualisht për në prerjen e gëlqerorëve të ujrave të cekëta.

Pjesa e poshtme e prerjes

Pjesa e poshtme e prerjes përbëhet nga shtresa konglobrekçiesh me material ofiolitik (copa e grimca bazaltesh, gabrosh, mikrogabrosh etj.) dhe material karbonatik në një matriks të imët (me përmasa siltike dhe të rërës). Në fillim, këto depozitime kanë pamjen e një konglomerati polimiktik ku klaste të rrumbullakosura shfaqin forma këndore deri gati të rrumbullakosura, përmasat e të cilave levizin nga pebbles deri tek cobbles. Brenda matriksit, por edhe në klastet karbonatike, dallohen mikrofosile si: *Crescentiella morronensis*, *Bacinella irregularis*, *Lithocodium* sp., *Lenticulina* sp., fragmente algash, koralesh, ekinodermash dhe briozoarësh. Prerja vazhdon me disa shtresa konglobrekçiesh të cilat janë shumë të shpuara nga mikrobialite dhe me biokonstrukcione koralore të shoqëruara nga sfungjere dhe stromatoporoide.

Mikrofaunat e identifikuar përfaqësohen nga mikroproblematika si *Crescentiella morronensis*, *Bacinella irregularis*, *Lithocodium aggregatum*, *Radiomura cautica* dhe foraminifere si *Lenticulina* sp, *Protopenneroplis ultragranulata*,




Figura 1. Gjeologjia e rajonit të Malit të Shenjtë (shkalla 1: 25 000)

Coscinoconus campanelus, *Coscinoconus alpinus*, *Coscinoconus molestus*, *Pseudocyclamina* sp, fragmente algash, koraresh, briozoarësh, ekinodermash, ekstraklastesh.

Interpretim:

Konglobrekçiet mund të përcaktohen si

brekçie shpati sepse ato përbëhen nga material rifor i eroduar dhe nga fragmente organizmesh që kanë jetuar në mjediset rifore dhe foreslope. Duke u bazuar mbi intraklastet dhe bioklastet e përcaktuara, mund të marrim në konsiderate faktin që kanë qenë të formuar në shpatin e shelfit ose tek baza e shpatit.

PJESA E DYTË E PRERJES, GRAIN FLOW

Pjesa e mesme e prerjes karakterizohet nga gëlqerorë shtresë-mesëm me ngjyrë gri në një facie relativisht të thellë me gëlqerorë me thjerza e ndërshtresa silicore si dhe ndërshtresa mergelore dhe me amonite të vogla.

MIKROFACIET TIPIKE DHE BASHKËSHOQËRITË E TYRE MIKROFAUNISTIKE.

Një përshkrim i shkurtër i mikrofacieve dhe bashkëshoqërimeve e tyre makro- dhe mikropaleontologjike paraqitet me poshtë:

Wackestone me spikule sfungjeresh ku makrofauna përfaqësohet nga fragmente ekinodermash, bivalvash dhe sfungjeresh, kurse mikrofauna nga foraminifere bentike të vogla të tipit textularid, miliolidik dhe nodosariaceu, foraminifere të aglutinuara të vogla, foraminifere me text hialin si *Spirillina* sp., *Lenticulina* sp. dhe forma të tjera si *Montsalevia salevensis*, *Scythiolina-Histerolina*, *Ammobaculites* sp., *Nautiloculina* sp., gjithashtu kalpionelide si *Tintinnopsella longa*, *Tintinnopsella* sp.,? *Lorenziella* sp.

Mudstone-wackestone me material terrigjen të shumtë, me kuarc me përmasë siltike deri tek arenitike, me bioklaste të vogla, foraminifere hialine si *Spirillina* sp., foraminifere të aglutinuara të rralla dhe spikule sfungjeresh.

Packestone dhe packestone kokërr trasha ku makrofauna përfaqësohet nga fragmente ekinodermash, bivalvash, brahiopodësh, sfungjeresh, brizozaresh, gaforresh dhe mikrofauna nga foraminifere hialine të tipit *Lenticulina* sp., foraminifere tekstulariide ose foraminiferë shpuesë të tipit *Bullophora* sp., ose alga si *Terquemella* sp. Takojmë edhe klaste me struktura mikrobiale të përfaqesuara nga cianobaktere dhe struktura bacineloidë ose struktura cianobakteriale. Në disa raste, dallohet gjithashtu një ndryshim mikrofacional deri në tendencë rudstone.

Grainstone kokërrtrasha ku makrofauna përfaqësohet nga fragmente ekinodermash, brizozaresh, bivalvash dhe sfungjeresh, klaste me struktura mikrobiale dhe një mikrofaune e përfaqësuar

nga *Lenticulina* sp., foraminifere si *Protopenneroplis ultragranulata*, *Gaudryna ectypa*, *Charentia* sp., *Terquemella* sp., *Coscinophragma* sp., *Acruliammina* sp., ose foraminiferë të aglutinuara të ndryshme. Kampionet, duke përfshirë këtë mikrofaunë tregon një moshë **Beriasian** i sipërm-Valanxhinian i poshtëm.

Packestone-grainstone kokërr trasha me fragmente ekinodermash dhe bivalvash, litoklaste mikritike dhe klaste jo-karbonatike dhe klaste me struktura mikrobiale.

INTERPRETIM

Interpretohen si “**grain flow deposits**” (Lowe, 1982; Einsele, 1991; Stow et al., 1996) ku sedimenti ka qenë i furnizuar brenda disa episodësh të tipit “mass debris flows”. Një numër i madh bioklastesh ka qenë transportuar nga zonat më të cekëta, si fragmente koralesh, algash jeshile dhe foraminifere të mëdhenj.

PJESA E SIPËRME E PRERJES, KAMPIONET S1-S15, GËLQERORËT ME NGJYRË TË BARDHË

Wackestone me bioklaste të imëta ku makrofauna përfaqësohet nga fragmente bivalvorësh, sfungjeresh dhe ekinoidësh kurse mikrofauna nga foraminifere hialine të tipit *Lenticulina* sp., foraminifere të aglutinara të vogla, *Crescentiella* sp. të rralla, kalpionelide si ?*Lorenziella* sp. dhe kalcisfere si *Stomiosphaera echinata*, *Colomisphaera carpathica*, *Cadosina* sp., spikule sfungjeresh. Vrojtohet kuarc terrigjen i imët ose siltik dhe arenitik i imët.

Wackestone me bioklaste me përmasa arenitike ku makrofauna përfaqësohet nga fragmente gastropodësh, brizozaresh dhe me foraminifera hialine të tipit *Lenticulina* sp., foraminifere të aglutinuara, struktura mikrobiale të tipit *Bacinella-Lithocodium*, *Radiomura* sp., ose *Crescentiella morronensis*, alga si *Salpingoporella cf. pygmaea*,? kalpionelide, spikule sfungjeresh. Maktriksi është mikritik, lehtësisht i pigmentuar.

Packestone intraklastik - bioklastik (mikrobrecke) ku makrofauna përfaqësohet nga fragmente bivalvoresh

dhe ekinodermash dhe mikrofauna nga foraminifere të aglutinuara dhe hialine të tipit *Lenticulina* sp, *Protopeneroplis* sp, *Nautiloculina* sp, fragmente strukturash bacinelloide. Shkëmbi ka një pamje mikrobekçore me një matriks me ngjyrë kafe dhe me kuarc terrigjen me përmasë siltike.

Packestone bioklastik - intraklastik me pamje brekçore, me stilolite, ku makrofauna përfaqësohet nga fragmente bivalvësh, briozoarësh, gastropodësh dhe ekinodermash dhe mikrofauna nga foraminifere hialine të tipit *Lenticulina* sp, *Charentia cuvillieri* dhe alga si *Salpingoporella* cf. *pygmaea* dhe ? *Supiluliumaella* sp, struktura bacinelloide.

Wackestone-packestone intraklastik-bioklastik (mikrobekçe) ku makrofauna përfaqësohet nga fragmente bivalvorësh me silicifikime, ekinodermash, sfungjerësh dhe mikrofauna nga foraminifere bentike të vogla, foraminifere shpuesë dhe kore mikrobiale të tipit *Lithocodium* sp.

Wackestone intraklastik-bioklastik deri tek floatstone-rudstone ku makrofauna përbëhet nga fragmente ekinodermash, sfungjerësh, briozoarësh dhe mikrofauna nga nodule të tipit *Bacinnella-Lithocodium*, *Lithocodium* sp, *Crescentiella morronensis*, alga të kuqe si *Sporolithon rude*, foraminifere të aglutinuara të mëdhenj si *Pseudocyclammina* sp, *Everticyclammina* sp dhe *Coscinothrauma* sp, *Vercorsella* sp, alga si *Salpingoporella pygmaea*, fragmente gaforësh si *Carpathoporella occidentalis* dhe fragmente të rikristalizuara alga udoteaceje.

Mikrobialit me struktura mikrobiale stromatolitike të shoqëruara nga organizma mikroshpuesë dhe me *Radiomura cautica*.

Grainstone peloidal bioklastik i shoqëruar nga struktura mikrobiale të formuara me siguri rreth bioturbacioneve, me fragmente ekinodermash dhe bivalvësh dhe fragmente të rralla foraminiferësh.

Boundstone me sfungjerë, me kore dhe struktura mikrobiale, *Radiomura cautica* dhe çimenti i shoqëruar nga mikrobialite dhe struktura të tipit *Crescentiella* dhe

foraminifere të shpues.

Grainstone bioklastik-intraklastik ku makrofauna përfaqësohet nga fragmente ekinodermash, bivalvësh dhe briozoarësh dhe mikrofauna nga foraminifere bentike të aglutinuara si dhe alga *Salpingoporella* sp, anelide si *Terebella* sp, nodule të vogla të tipit *Lithocodium*, *Crescentiella* sp.

MBI ARGUMENTIMIN MOSHOR TË PRERJES

Analiza e depozitimeve karbonatike të cilat mbulojnë ofiolitet dhe kryesisht studimi i tyre nga pikpamja biostratigrafike, mikrofaciale dhe paleomjedisore jep të dhëna thelbësore për skemën e rindërtimit të historisë pas-vendosjes së këtyre depozitimeve.

Bashkëshoqërimet mikrofaunistike të percaktuara në seksionin e Malit të Shenjtë kanë bërë të mundur ndërtimin biozonal duke përbërë taksone bentike siç janë foraminiferët, algat gëlqerore dhe organizmat mikrobiale por edhe ato pelagjike si kalpionelidet dhe kalciferet. Një zonim i tillë sëbashku me të dhënat mikrofaciale ne jep mundësi për të koreluar depozitimet detare të thella me depozitimet detare të cekta dhe për të rindërtuar arkitekturën e buzinës së platformës karbonatike. Sidomos, mikrofosilet që gjenden në mjediset e shpatit dhe gjithashtu edhe në mjediset platformike të ceketa siç janë *Protopeneroplis ultragranulata*, *Coscinothrauma* sp., *Coscinoconus* sp. dhe *Neotrocholina* sp. dhe *Crescentiella morronensis* janë bashkëshoqërime faunistike të rëndësishme për rindërtimin e platformave karbonatike të Jurasikut të sipërm-Kretakut të poshtëm.

Bazuar në bashkëshoqërimet mikropaleontologjike të identifikuara në seksionin e Malit të Shenjtë, depozitimet e studiuara u përcaktuan me moshe Berriasian i sipërm-Valanginian i poshtëm dhe për pjesën e sipërme të prerjes, Valanginian i sipërm-? Hoterivian ku taksonet me të rëndësishme nga pikpamja biostratigrafike janë:

Pseudocyclammina lituus, *Protopeneroplis*

ultragranulata, *Mohlerina basiliensis*, *Coscinoconus cherchiaie*, *Coscinoconus elongatus* të cilat janë tipike për Jurasikun e sipërm, por që janë sinjalizuar gjithashtu në pjesën më të poshtme të Kretakut të Poshtëm. Sipas BouDhager-Fadel (2008), foraminiferet e mëdhenj bentik që i mbijetuan krizës Jurasiko- Kretake ishin kryesisht forma me guacke e forte, si *Pseudocyclamina* dhe *Everticyclamina* që kanë qenë të përshkruara gjatë prerjes tonë dhe tregojnë se ato vazhduan deri në Beriasian- Valanzhinian duke jetuar në një mjedis të cekët detar (Banner dhe Whittaker, 1991).

Montsalevia salevensis konsiderohet si një tregues moshor shumë i rendesishem. Është paraqitur për herë të parë nga Pfender (1938) pasi u përshkruar nga Charollais, Brönnimann dhe Zaninetti (1966) si *Pseudotextulariella salevensis* nga Valanzhinianin i Poshtëm e Salève- it, afërt Gjenevës (Zvicër). Specia u raportua më vonë në Valanzhinian nga Schroeder (1968) në Spanjë; nga Fourcade dhe Raoult (1973) në Algjeri; nga Azema et al. (1976) në rajonin e Mesdheut perëndimor. Zaninetti et al. (1987) në Zvicër, Chiocchini et al. (1988) në Itali dhe nga Altiner (1991) në Turqi, nga Bucur et al. (1995) në Serbi, në intervalin Beriasian i Sipërm

–Valanzhinian kurse Ivanova dhe Kolodziej (2004) e mencinojnë nga Beriasian-Valanzhinianin i gëlqerorëve në facies Štramberk, në Karpatat polake dhe pastaj në Itali nga Bruni et al., 2007. Hosseini dhe Conrad (2008) dokumentojnë prezencën e *M.salevensis* nga Beriasiani, në JP të Iranit. Një zonë valanzhiane me *Montsalevia salevensis* u themelua nga Ivanova (1999) në Ballkanë. Referenca të tjera për moshën valanzhiniane e *M. salevensis* vijne nga Vila, 1980; Darsac, 1983; Velić&Sokač, 1983; Boisseau, 1987; Velić, 1988; Ivanova 2000; Husinec & Sokač 2006; Schlagintweit & Gawlick, 2006; Granier & Bucur, 2011; Bonin et al, 2012).

Protopenneroplis ultragranulata (Gorbachik, 1971), fillimisht e përshkruar nga depozitimet e Kretakut të poshtëm në

Krime (Gorbachik,1977), e konsideruar për një kohë të gjatë si një marker për moshën Beriasian-Valanzhiniane, por më vonë e përshkruar në Titonianin i mesëm (Heinz & Isenschmidt, 1988) apo nga depozitimet e Baremianit (Bucur, 1993, 1997; Arnaud-Vanneau&Sliter, 1995, si *Protopenneroplis* sp.) por në literaturë, mjaft shpesh është përshkruar si specie të Beriasian-Valanzhinian të poshtëm (Azema et al., 1977; Azema et al., 1979; Salvini-Bonnard et al., 1984; Boisseau, 1987; Granier, 1987; Zaninetti et al., 1988; Bucur, 1988; Chiocchini et al., 1988; Velić, 1988; Chiocchini et al., 1994; Bucur et al., 1995 dhe Bucur 1993, 1997.

Haplophragmoides joukowsky u përcaktua së pari në depozitime që i përkasin Valanzhinianit (Charollais et al., 1966) dhe nga depozitimet të Beriasian-Valanzhinianit nga Darsac (1983), Bucur et al. (1995), Ivanova (2000). por edhe Hoterivianit (më saktë Hoterivianit të Poshtëm) (Bucur, 1988; Altiner, 1991; Velić & Sokač, 1983; Boisseau, 1987; Chiocchini et al., 1988; Velić, 1988; Altiner, 1991; Bucur et al., 1995; Ivanova, 2000; Husinec & Sokač, 2006; Schlagintweit & Gawlick, 2011).

Neotrocholina valdensis Reichel, 1955 e cila fillimisht u përshkrua si tipike e depozitimeve të Valanzhinianit (Reichel, 1955) si specie tip për Neotrocholinen, shpesh herë është përshkruar si tipike për depozitime që i përkasin vetëm Beriasian-Valanzhinianit (Vila, 1980; Darsac, 1983; Boisseau, 1987; Granier, 1987; Bucur, 1988; Chiocchini et al, 1988; Altiner, 1991; LupertoSinni& Masse, 1994; Bucur et al., 1995; Neagu, 1995; Clark & Boudagher-Fadel, 2001). Ajo konsiderohet fosil karakteristik Beriasianit të vonshëm - Valanzhinianit të hershem të VP të Anatolisë në Turqi (Altiner, 1991), në Itali (Chiocchini et al., 1988), në Romani (Bucur, 1988; Bucur et al., 2004a; Bucur and Săsăran, 2005). Schlagintweit dhe Ebli (1999), në Alpet Veriore, i caktuan *N. valdensis* një moshe Valanzhinian i hershem. Përhapja biostratigrafike e njohur e *N.valdensis*

eshte Beriasian i vonshem-Valanzhinian; speciet janë ndeshur nga zona e Mirditës (Shqipëria) me një moshe Valanzhinian me i hershem (Radoicic 2005)

Pfenderina neocomiensis është përshkruar për herë të parë nga Pfender (1938) nga Valanzhiniani i hershëm i Provinces dhe është përmendur shpesh nga Valanzhiniani nga Schroeder (1968) dhe Canerot (1984) në Spanjë dhe Bucur et al. (1995) në Serbi. Këta autorë e konsiderohen kjo speciet si një marker i mirë për këtë moshë.

Scythiolina-Histerolina Neagu 2000 është përshkruar nga Neagu 2000 nga JL e Dobrodjes, në Rumani, si tregues moshor i intervalit Beriasian i sipërm-Valanzhinian i poshtëm

Prania e kapionelideve si *Tintinopsella carpathica* (Beriasian i Sipërm) dhe *Tintinopsella longa* janë në favor të moshës Beriasian i sipërm-Valanzhinian i poshtëm.

Një takson me një rëndësi të vecantë është gjithashtu kalcsifera *Stomiosphaera echinata*, e cila përfaqëson zonën me *Stomiosphaera echinata* tipike për moshën **Valanzhinian i sipërm-Hoterivian** përcaktuar në kampionin S3 të pjesës së sipërme të prerjes tonë. Nëse gëlqerorët e pjesës së dytë të prerjes përfshijnë specie tipike për intervalin Beriasian i sipërm-Valanzhinian i poshtëm (e.g., *Montsalevia salevensis*, *Neotrocholina valdensis*, *Protopenneroplis ultragranulata* dhe *Haplophragmoides joukowsky*), një takson si *Stomiosphaera echinata* është më shumë përfaqësues për një moshë Valanzhinian i sipërm-Hotrivian i poshtëm. (Reháková D, 2000a), me një përhapje biostratigrafike deri në Aptian.

Megjithatë, datimet moshore të studimit tonë që janë kryer mbi bazën e foraminifereve, kalpsionelideve dhe dinocisteve tregojnë një moshë më të vjetër, Beriasian i sipërm-Valanzhinian i poshtëm dhe një moshë Valanzhinian i sipërm-Hotrivian.

DISA KONSIDERATA PALEOMJEDSORE

Natyrë e sedimentimit të thellë i natyrës pelagjike të depozitimeve të shpatit

të karbonateve të Malit të Shenjtë karakterizohen nga prania e kalpsionelideve dhe foraminifereve me guacke xhamore si *Lenticulina* sp, *Nodosaria* sp dhe *Spirillina* sp që janë foraminifere bentike tipike e mjediseve të hapura detare. Taksonet që janë të pranishme në buzinën e shelfit, që për shkak të transportit deri tek faciet e shpatit dhe tek zonat lagunare mbrapa rifit, janë forma shumë të rëndësishme që sigurojnë mundësinë e përcaktimit të biozonimeve detare pelagjike dhe ato të cekta, dhe gjithashtu, rindërtimin e biznes të platformës. Në prerjen tonë kemi identifikuar forma të tilla "kyq", si *Protopenneroplis ultragranulata*, *Coscinochasma* sp, *Coscinoconus* spp, *Neotrocholina* sp dhe *Crescentiella morronensis* që takohen edhe në **faciet kalcsiturbiditike të shpatit**. Nga ana tjetër, disa foraminifere bentike të aglutinuara, të mëdhej si *Everticyclaminina* sp. *Pseudocyclamina* sp ose foraminiferë të tjera si *Charentia cuvillieri*, *Charentia* sp dhe *Nautiloculina* sp, normalisht janë të kufizuar në mjediset e mbrapa rifit, megjithse, ato nganjëherë mund të transportohen në faciet pararifore.

Organizmat me natyrë mikrobiale si *Lithocodium*, *Bacinella* (struktura bacinellide) dhe *Koskinobulina* janë të zakonshme në faciet e back-reef-it, por janë të rralla në faciet margjinale rifore më të cekëta. *Crescentiella morronensis* takohet në mjediset të cekëta (lagunë, rife) por edhe në mjediset më të thella (rife sfungjeresh, **facie shpati**). *Radiomura cautica* e takojmë në faciet rifore dhe pararifore.

Duke marrë në konsiderat format e mësipërme, ka qene e mundur interpretimi i depozitimeve të studiuara si facie turbiditike të shpatit dhe ky model i shpërndarjes është në përputhje me modelet e njohura të platformave karbonatike të tjera në arealin Tethyan (Pleš et al., 2013; Kaya dhe Altner, 2015).

Bashkëshoqërimi "*Lithocodium-Bacinella*" i përcaktuar në prerjen e studimit është tipik mjediseve të shelfit dhe ishte prezent përgjatë Tethysit verior dhe Atlantikut të Veriut, e takojmë në faciet lagunore, ashtu

edhe në rifet koralore (Leinfeder et al., 1993).

Karbonatet e Malit të Shenjtë përfaqësohen nga depozitime kalciturbiditike të shkaktuara nga rrjedhje gravitacionale të facieve MF4, MF5 dhe MF6 dhe të përziera me një sfond sedimentimi pelagjik të vazhdueshëm të facieve MF1, MF2 dhe MF3 (facie tipike platformave karbonatike të Kretakut i poshtëm sipas Arnaud-Vanneau 2004). Prania e materialit të cekët detar të transportuar në sekuencat basinale dhe shfaqja e elementeve pelagjike brenda matriksit të këtyre facieve tregon pulsacione të proceseve të rrjedhjes gravitative (gravity flows). Këto depozitime janë në fakt depozitime masive të tipit “debris-flow” sipas përshkrimit të Drzewiecki dhe Simó, 2002 dhe moshë e tyre është Beriasian i sipërm-Valanxhinian i sipërm.

Karbonatet të shpatit me mikrofacie dhe përmbajtje fosile të ngjashme janë përshkruar edhe më tutje në perëndim nga Serbia (Petrova et al., 2012, Gëlqerori Rosomać), Polonia (Matyszkiewicz & Slomka, 1994, Limeshtari Cieszyn, Karpatet e Jashtëme), Alpet Veriore (Schlagintweit & Gawlick, 2007, the Barmstein Limestone; Schlagintweit & Ebli, 1998, the Tressenstein Limestone and

Auer et al., 2006, the Rettenstein Debris Flow), Rumania (Bucur et al. 2010, Mateiaș Limestone, Karpatet Jugore) dhe Sllovenia (Kukoc et al. 2012, Dinaridet e brendshme).

PËRFUNDIME

Në prerjen e Malit të Shenjtë të studiuar janë identifikuar mikrofacie dhe bashkëshoqëri mikrofaunistike ku format më të rëndësishme nga pikepamja biostratigrafike dhe paleomjedisore kanë bërë të mundur ndërtimin biozonal dhe paleomjedisor me përbërje taksone bentike siç janë foraminiferët, algat gëlqerore dhe organizmat mikrobiale por edhe ato pelagjike si kalpionelidet dhe kalciferet, bashkëshoqërime që tregojnë një moshë Beriasian i sipërm-Valanxhinian dhe për herë të parë paraqesim të dhena të rëndësishme për praninë e niveleve të Beriasian-Valanxhinianit në pjesën më të poshtme të platformes karbonatike të Malit të Shenjtë, duke ofruar informacion thelbësor në lidhje me rindërtimin e historisë post- vendosjes së këtyre depozitimeve

REFERENCE

- ALTINER, D., 1991.** Microfossil biostratigraphy (mainly foraminifers) on the Jurassic-Lower Cretaceous
- ARNAUD-VANNEAU, A. & SLITER, W.V., 1995.** Early Cretaceous shallow-water benthic foraminifera and fecal-pellets from Leg-143 compared with coeval faunas from the Pacific basin, Central America and Tethys. In: *Winterer et al. (eds.) Proceedings of the Ocean Drilling Program, Scientific Results*, 143: 537-564.
- ARNAUD-VANNEAU & ARNAUD H,** Carbonate facies and microfacies of the Lower Cretaceous Carbonate Platform.
- AUER, M., GAWLICK, H.-J. AND SCHLAGINTWEIT, F., 2006.** Mount Rettenstein southeast of the Dachstein Massif – a structurally controlled, isolated occurrence of Jurassic strata at the southern rim of the Northern Calcareous Alps. In: *M. Tessadri Wackerle, (ed.), PANGEO Austria 2006, pp. 7-8, Innsbruck University Press*
- AZEMA, J., CHABRIER, G., FOURCADE, E. & JAFFREZO, M., 1977.** Nouvelles données micropaléontologiques, stratigraphiques et paléogéographiques sur le Portlandien et le Néocomien de Sardaigne. *Revue de Micropaléontologie*, 20 (3): 125-139.
- AZEMA, J., CHABRIER, G., CHAUVE, P. & FOURCADE, E., 1979.** Nouvelles données stratigraphiques sur le Jurassique et le Crétacé du Nord-Ouest d'Ibiza (Balears, Espagne). *Geologica Romana*, 18: 1- 21.
- BANNER, F.T., WHITTAKER, J.E., 1991.** *Redmond's "new lituolid Foraminifera" from the Mesozoic of*

Nivele të Beriasian-Valanzhinianit në pjesën e poshtme të platformës karbonatike të Malit të Shenjtë

Saudi Arabia: Micropaleontology, 37, 41–59.

BOISSEAU, T., 1987. La plate-forme jurassienne et sa bordure subalpine au Berriasien-Valanginien (Chartreuse-Vercors). Analyse et corrélation avec les séries de bassin. *Thèse Univ. Grenoble*, 413 pp.

BONIN, A., VENNIN, E., PUCÉAT, E., GUIRAND, M., ARNAUD-VANNEAU, A., ADATTE, T., PITTET, B., MATTIOLI, E., 2012. Community replacement of neritic carbonate organisms during the late Valanginian platform demise: A new record from Provence platform. *Palaeogeography, Palaeoclimatology, Palaeoecology*, 365-366: 57-80.

BOU DHAGER-FADEL, M., 2008. Evolution and geological significance of larger benthic foraminifera, in Wignall, P.B. (Ed.), *Developments in Palaeontology and Stratigraphy 21, Elsevier Amsterdam*, 515 p.

BRUNI, R., BUCUR, I., PREAT, A., 2007. *Uppermost Jurassic-Lowermost Cretaceous carbonate deposits from Fara San Martino (Maiella, Italy): biostratigraphic remarks: Studia Universitatis Babeş-Bolyai, Geologia* 52 (2), 45–54.

BUCUR, I.I., 1988. Les foraminifères du Crétacé inférieur (Berriasien-Hauteriviens) de la zone de Reşiţa-Moldova Nouă (Carpathes Méridionales, Roumanie). Remarques biostratigraphiques. *Revue de Paléobiologie, Vol. Spéc. 2 (Benthos '86):379-389.*

BUCUR, I.I., 1993. Les représentants du genre *Protopenneroplis* Weynschenk dans les dépôts du Crétacé inférieur de la zone de Reşiţa-Moldova Nouă (Carpathes Méridionales, Roumanie). *Revue de Micropaléontologie*, 36 (3): 213-223.

BUCUR, I.I., CONRAD, M.A., RADOIČIĆ, R., 1995. *Foraminifers and calcareous algae from the Valanginian limestones in the Jerma River Canyon, Eastern Serbia. Revue de Paléobiologie*, 14 (2): 349-377.

BUCUR, I.I., 1997. *Representatives of the genus Protopenneroplis (Foraminifera) in the Jurassic and Lower Cretaceous deposits in Romania. Comparisons with other regions of the Tethyan area. Acta Palaeontologica Romaniae*, 1: 65-71.

BUCUR, I.I., SĂSĂRAN, L., SĂSĂRAN, E., SCHULLER, V., 2004A. Micropaleontological study of the limestone oolites within the Upper Cretaceous wildflysh from Hăşdate (eastern border of the Gilău Mountains). *Acta Paleontologica Romaniae*, 4, 55–67.

BUCUR, I.I., SĂSĂRAN, E., 2005. Micropaleontological assemblages from the Upper Jurassic-Lower Cretaceous deposits of Trascău Mountains and their biostratigraphic significance. *Acta Paleontologica Romaniae*, 5, 27–38

BUCUR ET AL, 2011. *New data on facies development and micropaleontology of the eastern margin of the Getic Carbonate Platform (South Carpathians, Romania): Case study of the Mateiaş Limestone, Studia Universitatis Babeş-Bolyai, Geologia*, 2010, 55 (2), 33– 41

CANEROT, J., 1984. Fluctuations marines et évolution: exemple du Néocomien des Ibérides orientales, in: Oertli, H.J. (ed.), *Benthos 83-2nd, International Symposium on Benthic Foraminifera. Elf Aquitaine, Esso Rep and Total CFP*, 131–139.

CHAROLLAIS, J., BRÖNNIMANN, P. & ZANINETTI, L., 1966. Troisième note sur les foraminifères du Crétacé inférieur de la région genevoise. Remarques stratigraphiques et description de *Pseudotextulariella salevensis*, n. sp.; *Haplophragmoides joukowskyi*, n.sp.; *Citaella? favrei* n. sp. *Archives des Sciences S.P.H.N. Genève*, 19 (1): 23-48.

CHIOCCHINI, M., MANCINELLI, A. & MARCUCCI, C., 1988. Distribution of benthic foraminifera and algae in the Lazio-Abruzzi carbonate platform facies (Central Italy) during Upper Malm-Neocomian. *Revue de Paléobiologie, Vol. Spéc. 2 (Benthos '86):219-227.*

CHIOCCHINI, M., FARINACCI, A., MANCINELLI, A., MOLINARI, V. & POTETTI, M., 1994. Biostratigrafia a foraminiferi, dasci cladali e calcipionelle delle successioni carbonatiche mesozoiche dell'Appennino centrale (Italia). *Studi Geologici Camerti, Vol. Spéc. "Biostratigrafia dell'Italia centrale"*, pp.9-128.

DARSAC, C., 1983. La plate-forme berriasio-valanginienne du Jura méridional aux massifs subalpins (Ain, Savoie). Sédimentologie, minéralogie, stratigraphie, paléogéographie, micropaléontologie. *Thèse, 3^e cycle, Université Grenoble*, 319 pp.

EINSELE, G., 1991. Submarine mass flow deposits and turbidites. In: Einsele et al. (eds.) *Cycles and events in stratigraphy. Springer-Verlag*, p. 313-340, Berlin.

FOURCADE, E., RAOULT, J.F., 1973. Crétacé du Kef Hahouner et position stratigraphique de

Ovoalveolina reicheli de Castro (série septentrionale du môle néritique du Constantinois, Algérie): *Revue de Micropaléontologie*, 15, (4) 227–246.

GAWLICK ET AL. 2008. Mirdita Zone ophiolites and associated sediments in: *Albania reveal Neotethys Ocean origin, June 2008 International Journal of Earth Sciences* 97(4):865-881

GORBACHIK, T.N., 1971. On Early Cretaceous foraminifera of the Crimea. *Akademia Nauk, Voprosy Micropaleontologii*, 14: 125-139. (in Russian).

GORBACHIK, T. N. & MOHAMAD, G.K., 1977. New species of Lituolida (Foraminifera) from the Tithonian and Berriasian of the Crimea. *Paleontological Journal*, 31 (4): 345-351 (Translated from *Paleontologicheskii Zhurnal*, 4, p.3-9).

GRANIER, B., 1987. Le Crétacé inférieur de la Costa Blanca entre Busot et Altea (Alicante, Espagne): biostratigraphie, sédimentologie, évolution tectono- sédimentaire. *Thèse Univ. P. et M. Curie*, 281 pp.

GRANIER & BUCUR, 2011. Stratigraphic ranges of some Tithonian-Berriasian benthic foraminifers and Dasycladales. Re-evaluation of their use in identifying this stage boundary in carbonate platform settings. *Boletín del Instituto de Fisiografía y Geología* 79-8.

HEINZ, R.A. & ISENSCHMID, C.H., 1988. Microfazielle und stratigraphische Untersuchungen im Massivkalk (Malm) der Préalpes médians. *Eclogae Geologicae Helvetiae*, 81 (1): 1-62.

HOSSEINI, S.A., CONRAD, M.A., 2008. Calcareous algae, foraminifera and sequence stratigraphy of the Fahliyan Formation at Kuh-e-Surmeh (Zagros Basin, SW of Iran): *Geologia Croatica*, 61 (2-3), 215–237.

HUSINEC, A. & SOKAČ, B., 2006. Early Cretaceous benthic associations (foraminifera and calcareous algae) of a shallow tropical-water platform environment (Milet Island, southern Croatia). *Cretaceous Research*, 27: 418 - 441.

IVANOVA, D., 1999. Middle Callovian to Valanginian microfossil biostratigraphy in the west Balkan Mountain, Bulgaria (SE Europe): *Acta Paleontologica Romaniaae* 2, 231–236.

IVANOVA, D., 2000. Middle Callovian to Valanginian microfossil biostratigraphy in the West Balkan Mountain, Bulgaria (SE Europe). *Acta Palaeontologica Romaniaae*, 2 (for 1999): 231-236.

IVANOVA, D., KOŁODZIEJ, B., 2004. New foraminiferal data on the age of Stramberk-Type limestones, Polish Carpathian: *Comptes Rendus de l'Académie Bulgare des Sciences*, 57 (12), 69–74.

KAYA M.Y., ALTINER D., 2015. Microencrusters from the Upper Jurassic– Lower Cretaceous İnalti Formation (Central Pontides, Turkey): remarks on the development of reefal/peri-reefal facies. *Facies* 61:18

KUCOC ET AL, 2012. Lower Cretaceous carbonate gravity-flow deposits from the Bohinj area (NW Slovenia): Evidence of a lost carbonate platform in the Internal Dinarides, September 2012, *Bulletin de la Societe Geologique de France* 183(4):383-392

LEINFELDER, R. R., NOSE, M., SCHMID, D. U. & WERNER, W., 1993. Microbial crusts of the Late Jurassic: Composition, palaeoecological significance and importance in reef construction. *Facies*, 29: 195 - 230.

LOWE, D.R., 1982. Sediment gravity flows. II. Depositional models with special reference to the deposits of high-density turbidity currents. *J.Sed.Petrol.*, 52, p. 279-297.

MARCUCCI, M., KODRA, A., PIRDENI, A., GJATA, TH., 1994. Radiolarian assemblage in the Triassic and Jurassic cherts of Albania. *Ofioliti* 19, 105-115.

Marcucci & Prella M., 1996. *The Lumi i Zi (Puke) section of the Kalur Cherts: Radiolarian assemblages and comparison with other sections in northern Albania, Ofioliti*, May 1996.

MATYSZKIEWICZ, J. & SŁOMKA, T. 1994. Organodetrital conglomerates with ooids in the Cieszyn Limestone (Tithonian-Berriasian) of the Polish Flysch Carpathians and their paleogeographic significance. *Annales Societatis Geologorum Poloniae*, 53, 211-248.

MEÇO, S., DODONA, E., MELO, V., 1975. Përpykjet për ndarjen zonale të depozitimeve Berriasiane të Krahinës së Fanit. (Zona Tektonike e Mirdites) në baze të amoniteve e tintinideve. *Permb. Stud. 1/1975, f.7-15, Tirane*

MELO, V., KOTE, DH., DODONA, E., 1971. Mbi transgresionin e Berriasianit në rajonin e Xhuxhes. *B.U.T. ser. Shkenc. Nat. Nr.1, Tirane.*

NEAGU, T. 2000. Lower Cretaceous calcareous agglutinated Foraminifera from Southern Dobrogea, Romania. Part II. Early Cretaceous Cuneolinidae. In: *Hart, M.B., Kaminski, MA. & Smart, C.W.*

Nivele të Beriasian-Valanzhinianit në pjesën e poshtme të platformës karbonatike të Malit të Shenjtë

(eds), *Proceedings of the Fifth International Workshop on Agglutinated Foraminifera*. Grzybowski Foundation Special Publication, 7, 363-386

PETROVA, S., RABRENOVIĆ, D., LAKOVA, I., KOLEVA-REKALOVA, E., IVANOVA, D., METODIEV, L. AND MALEŠEVIĆ N., 2012. Biostratigraphy and microfacies of the pelagic carbonates across the Jurassic/Cretaceous boundary in eastern Serbia (Stara Planina-Poreč Zone). *Geologica Balcanica*, 41(1-3), 52-76.

PEZA, L.H., PIRDENI, A., TOSKA, Z., 1983. Depozitimet kretake ne rajonin Kurbnesh - Krej Lur dhe te dhenat per zhvillimin paleogeografik te zones se Mirdites gjate Jurasikut te siperm dhe Kretakut. *Bul. Shk. Gjeol.*, 4/1983, 71-95.

PLES G, MIRCESCU C.V., BUCUR I.I., SASARAN., 2013. Encrusting microorganisms and microbial structures in Upper Jurassic limestones from the Southern Carpathians (Romania). *Facies* 59:19–48
Pfender J: Les Foraminifères du Valanginien provençal. *Bull. Soc. Geol. France*, vol 8, 5series, no pp.231-242, pls. 13-16, Paris 1938

PRELA ET AL., 2000. Jurassic radiolarian biostratigraphy of the sedimentary cover of ophiolites in the Mirdita Area, ALBANIA: new data. *May 2000, Ofioliti* 25(1):55-62

RADOIČIĆ, R., 2005. New Dasycladales and microbiota from the lowermost Valanginian of the Mirdita Zone: *Annales Géologiques de la Péninsule Balkanique*, 66, 27–53.

REHÁKOVÁ D. 2000. Evolution and distribution of the Late Jurassic/Early Cretaceous calcareous dino flagellates recorded in the Western Carpathian pelagic carbonate facies. *Miner. Slovaca*, 32, 79- 88

REICHEL, M., 1955. Sur une trocholine du Valanginien d'Arzier. *Eclogae Geologicae Helveticae.*, 48 (2): 396-408.

SALVINI-BONNARD, G., ZANINETTI, L. & CHAROLLAIS, J., 1984. Les foraminifères dans le Crétacé inférieur (Berriasien moyen-Valanginien inférieur) de la région de la Corraterie, Grand-Salève (Haute Savoie, France): inventaire préliminaire et remarques stratigraphiques. *Revue de Paléobiologie*, 3 (2). 175-184.

SCHLAGINTWEIT, F., EBLI, O., 1999. New results on microfacies, biostratigraphy and sedimentology of Late Jurassic-Early Cretaceous platform carbonates of the northern calcareous Alps. Part 1 Tessenstein Limestone Plassen Formation. *Abhandlungen der Geologischen Bundesanstalt*, 56 (2), 379–418.

SCHLAGINTWEIT, F., GAWLICK, H.J., MISSONI, S., LEIN, R., HOXHA, L., 2006. Late Jurassic to Early Cretaceous dasycladales and benthonic foraminifera from the *Munella* carbonate platform s.l. of the Mirdita Zone. *XIII-th Congress of Carpatian-Balkan Geological Association*. p. 527 – 530.

SCHLAGINTWEIT F, GAWLICK J., 2007. Analysis of Late Jurassic to Early Cretaceous algal debris-facies of the Plassen carbonate platform in the Northern Calcareous Alps (Germany, Austria) and in the Kurbnesh area of the Mirdita zone (Albania): A tool to reconstruct tectonics and palaeogeography of eroded platforms, *April 2007, Facies* 53(2):209-227

SCHLAGINTWEIT ET AL., 2012. Onset of an Aptian carbonate platform on top of a Middle-Late Jurassic radiolaritic-ophiolitic mélange in the Mirdita Zone of Albania, *December 2012. Geologia Croatica* 65(1):29-40

SCHROEDER, R., 1968. Sobre algunos foraminíferos del Valanginiense de la Sierra de Valdencha (Provincia de Castellón): *Boletín de la Real Sociedad Española de Historia Natural (Geológica)*, 66, 311–318

STOW, D. A. V., READING, H. G., COLLINSON 1996. Deep seas, in H. G. Reading (ed.): *Sedimentary Environments: Processes, Facies and Stratigraphy*. Blackwell Science, Third Ed., p. 395-453.

VELIĆ, I. & SOKAČ, B., 1983. Stratigraphy of the Lower Cretaceous index fossils in the Karst Dinarids (Yougoslavia). *Zitteliana*, 10: 485-491.


VELIĆ, I., 1988. Lower Cretaceous benthic foraminiferal biostratigraphy of the shallow-water carbonates of the Dinarids. *Revue de Paléobiologie, Vol. Spéc. 2 (Benthos'86)*: 467-475.

VILA, J.M., 1980. La chaîne alpine d'Algérie orientale et des confins algéro-tunisiens. *Thèse, Univ. P. et M. Curie*, 665 pp.


ZANINETTI, L., CHAROLLAIS, J., CLAVEL, B., DECROUEZ, D., SALVINI-BONNARD, G. & STEINHAUSER, N., 1988. Quelques remarques sur les fossiles du Salève (Haute- Savoie, France). *Archives des Sciences Genève*, 41 (1):43-63.

XHOMO, A. ETJ., 2002. *Gjeologjia e Shqiperise*. 404 faqe.

Uta A.



Nivele të Beriasian-Valanzhinianit në pjesën e poshtme të platformës karbonatike të Malit të Shenjtë



Uta A.




Plate 1. M4-Coscinoconus sp; M5Coscinoconus cherchiaie; M5-1-Coscinoconus campanellus; M7d-8-Coscinoconus molestus M7d-9-Protopenneroplis ultragranulata; M17-Neotrocholina friburgensis; M17-10-Protopenneroplis ultragranulata; M19-3-Neotro- cholina sp; M26-Montsalevia salevenis; M27(10x)-Montsalevia salevensis; M30(10x)-Scythiolina-Histerolina; M31(10x) Scytioli- na-Histerolina; M32(10x)-Protopenneroplis ultragranulata; M33(10x)-Spirillina; M35(10x)-Nodosaria sp; M36(10x)-Lenticulina; M43-1(10x)-Neotrocholina sp; M44(10x)-Protopenneroplis ultragranulata; M41(10x)-Bullophora sp; M49(x10)-Novalesia sp; M44(10x)-Gaudryna ectypa; M45(10x)-Acruliamina; M50(10x)-Amobaculites; M50-1(10x)-Scytiolina&textulariid; M50-2(10x)-Montsalevia salevensis; M51(10x)-Montsalevia sp; M54(10x)-foraminifer textularid

Plate 2. S2(10x)-Protopenneroplis ultragranulata; S2(5x)-Nautiloculina sp; _S12(5x)-Charentia cuvillieri; S13(2.5x) - foraminifer duke shpuar nje sfungjere; S14-2(5x-1zum)-Coscinophragma; S14-3(10x)-Everticy- clammina; S14-4(10x)-Vercorsella; S15(10x)-Spirilina sp; S15-2-Lenticulina sp; S15-3 Haplophragmoides joukowsky; S14-9-Foraminifer ind; S15-1 ?Supiluliumaella sp; S14-5-Sporolithon rude LEMOINE; S17-3-Pfenderina neocomiensis; S19-Charentia cuvillieri; S15-5(10x1zum)-Salpingoporella pygmaea; S14-6(5x)-?Salpingoporella; S14-7(5x)-Salpingoporella pygmaea; M7d-1-Actinoporella podolica; S14-9; Salpingoporella pygmaea; S14-10; Terquemella sp; M45-2-Terquemella sp; M17-8-Terquemella sp; M7d-12; Carpathoporella occidentalis

Plate 3. S13-2(5x)-Lithocodium; S13-2(5x) S13-2(5x); S14-1(5x)-Crescentiella morronensis; S14-1(10x)-Crescentiella morronensis; S14-4(5x)-Radiomura cautica; M48(2.5x)-Structuri cianobacteriale; M30(20x)-Tintinopsella; M33(20x)-Tin- tinopsella longa; M52(20x)-Lorenziella; S3(20x)-Lorenziella; S3(20x)-Stomiosphaera echinata; M18-Tintinopsella carpathica; M19-Calpionell alpina; M19-4-Calpionella alpina; S15-8-Colomisphaera carpathica; S18-Cadosin sp; S18-5-?Cadosina sp; S18-9-Calpionellites sp

THE PRESENCE OF BERIASSIAN-VALANGINIAN AT THE BASAL PART OF MALI I SHENJTE CARBONATE PLATFORM

ANDREEA UTA*

ABSTRAKT

This paper presents the preliminary results of a detailed biostratigraphical and microfaciesal study of the carbonate deposits found at the basal part of Mali i Shenjte carbonate platform (Mirdita zone). Benthic foraminifera and "microproblematica" (microbial organisms) are the major constituents of the Lower Cretaceous reefs and carbonate platforms environments. It has also been proven that they are of particular importance for their biostratigraphic zonations. Being a mixture of typical elements of shallow environments (foraminifera and microproblematica) and typical elements of deep environments (calpionelids and calcispheres), the microfacies described in this study are typical for an allodapic limestone (turbidites) and the whole carbonate section can be interpreted as slope sediments and gravity flows. On the basis of the associations of foraminifera, calcareous algae, microproblematica and calpionelids, the age of these deposits was assigned assigned to Beriassian-Valanginian, levels of this age being presented for the first time in the region.

Key words: *microfacies, microbial structures, foraminifera, calcareous algae, calpionelids, Beriassian-Valanginian, Mali i Shejnte, Mirdita.*

INTRODUCTION

The geological study of the Jurassic-Cretaceous and Cretaceous carbonate deposits largely extending above the ophiolites and their primary sedimentary cover is of capital importance to reconstruct the history of geological evolution of Mirdita zone. The vastly different regional geological interpretations performed by many authors raised the need to more detailed studies that would help create a more reliable version of the evolution of this area.

HISTORY OF GEOLOGICAL STUDIES OF MALI I SHENJTE CARBONATE PLATFORM

Most studies (Peza et al. 1981, 1983; Peza & Marku 2002; Xhomo et al. 2002, 2005) have dealt with the geological structure Mali i Shenjte carbonate deposits as part of a large carbonate platform of Baremian-Aptian age transgressively lying above the Jurassic-Cretaceous deposits of Firza flysch

or above the ophiolites and their primary sedimentary cover.

The oldest age of these deposits was considered as Lower Aptian by Gawlick et al. 2008 and Schlagintweit et al. 2011 and the same authors have also considered the age of the Jurassic-Cretaceous Firza flysch from the northwest and western part of Mali i Shenjte as Bathonian-Oxfordian.

This paper brings important data regarding the presence of the Beriassian-Valanginian levels at the basal part of Mali i Shenjte carbonate platform.

GEOLOGICAL BACKGROUND

The ophiolites of Mirdita zone represent remnants of the Triassic and Jurassic oceanic lithosphere, with better preservation throughout the Dinarid-Albanid-Helenid belt of the Alpine Orogenic System. During the extension to the closure of Mirdita oceanic basin, the primary sedimentary cover of the ophiolites was represented

*Institutin i Gjeoshkencave, Energjise, Ujit dhe Mjedisit, Rruga Don Bosko 60. Tirana, Albania
e-mail: andrea.uta@gmail.com

by Middle Jurassic radiolarites (Marcucci et al., 1994, April 1996, 2000) and Simoni "block in matrix melange" of Middle-Upper Jurassic and Callovian- Lower Oxfordian age (Xhomo et al. 2002, Kodra & Hoxha 2019). After the closure of Mirdita oceanic basin, the Upper Jurassic, Jurassic-Cretaceous and Cretaceous deposits were covered the ophiolites and their primary sedimentary cover. In Albania, the evidence of the Upper Jurassic deposits is limited to a small occurrence in Kurbnesh region, where the breccia with Kimmeridgian limestone fragments was redeposited within the Upper Tithonian-Beriasian Firza flysch (Gawlick et al. 2008; Schlagintweit et al. 2012). The Upper Jurassic deposits have been documented by Elezaj & Kodra 2008, Kodra et al., 2009, Sukaj 2016 in the Voljak-Gurii Zi region, Kosovo. The formation of the Simoni melange and the above obducted peridotites are discordantly covered the ophiolitic breccia and radiolarites, fragments of Oxfordian-Kimmeridgian deposits followed by the so called Valljahu flysch of Kimmeridgian-Tithonian age. The Upper Tithonian-Valanginian Firza flysch deposits have a widely spread in Mirdita zone also including the region studied by us (Fig. 1). (Melo et al., 1971; Meco et al. 1975; Peza et al., 1983; Gawlick et al., 2008, Uta 2018). The Cretaceous deposits are generally transgressively lying above the subsequent deposits (Peza et al. 1981.; Xhomo et al., 2002, 2005).

The stratigraphic section Shenjti 1 (Shelbumi)

The stratigraphic section was carried out in Mali i Shenjte mountain range, north of Shelbum, on the edge of the motorway, near the village of Nenshejt. In contrast to the usual geological situations encountered in the region, where the Cretaceous deposits transgressively overlies the Upper Tithonian-Valanginian Firza flysch deposits, the Shenjti 1 section belongs to the lowest part of Mali i Shenjte carbonate platform. This section has no significant tectonic faults which could have affected the normal sedimentary succession.

The whole section was divided into 3 parts: a basal part, a middle part and an upper part where during some field trips performed between 2015-2016 we have been sampled a number of about 130 samples for microfossil and micropaleontological analysis. After analysing the thin sections of these samples, we determined the typical microfossils and their micropaleontological associations using groups as benthic foraminifera, calcareous algae, incerta sedis, calpionelids and calciphers.

